

PROCESVERBAL
nga seanca e 6-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 29.8.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, dr. Metodija Jançeski, L Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nëpërmjet lidhjes video-konferencë ishte i pranishëm dhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, Shqipe Tahiri, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski e hapi seancën e 6-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

RENDI I DITËS

1. Arsyetim nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive Televizioni POLOG SHPKNJP Tetovë, për veprimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes.
2. Të ndryshme.

Z. Petrushevski konstatoi se përfaqësuesi i medias nuk ka qenë i pranishëm në seancë edhe pse ishte i ftuar me rregull. Në këtë drejtim, ai kërkoi sqarim nga drejtori z. Trajçevski, nëse ka ndonjë informacion në lidhje me median.

Z. Trajçevski pohoi se nuk ka përfaqësues të pranishëm nga SHTR Televizioni POLOG SHPKNJP Tetovë dhe sqaroi se këtë mëngjes bisedë telefonike ka pasur udhëheqësi i Sektorit për financa dhe logjistikë Goran Radunoviq me drejtorin e televizionit i cili ka paralajmëruar se ndoshta do t'i paguajnë mjetet. Ai ka shpjeguar se disa herë gjatë ditës së sotme ka kryer kontrollë nëse ka pasur pagesë dhe kontrolli i fundit ka qenë para fillimit të seancës, por tha se transmetuesi nuk i ka paguar mjetet për kompensim vjetor të lejes.

Z. Petrushevski propozoi që edhe një herë të kontrollohet pagesa kur në seancën e 28-të do të shqyrtohet pika për heqjen e lejes. Sepse kjo seancë ka për qëllim arsyetimin e medias në lidhje me procedurën e inicuar për heqjen e lejes ndërsa përfaqësuesi i medias nuk ishte i pranishëm, seancën e deklaroi të mbyllur.

Nr.02-3273/2

06.09.2023
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

